



AKT - THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE "TOP ALBANIA" SH.A

Pjestarët e krijimit të shoqërisë tregtare "TOP ALBANIA" SH.A të mbledhur sot më 05.05.2000, bazuar në ligjin "Për Shoqëritë Tregtare" Nr. 7638 datë 19.11.1992, në Ligjin "Për rregjistrimin e shoqërive tregtare" Nr. 7667 datë 28.01.1993, si dhe në Ligjin Nr. 8410 datë 30.09.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë" vendosën themelimin e shoqërisë "TOP ALBANIA" SH.A.

Ortakët themelues të shoqërisë janë:

- 1- Znj. Vjollca Hoxha, e bija e Shaqir, lindur më 1969 në Tiranë dhe banuese në Tiranë, në adresën Rr. "Pandi DARDHA: Pall.32/1, identifikuar me pasaportën Nr.0345394.
- 2- Znj. Zhuljeta Lamaj, e bija e Fores, lindur më 1968 në Tiranë dhe banuese në Tiranë, në adresën e mësipërme, identifikuar me pasaportën Nr.0114940.
- 3- Zyhra HAMITI, e bija e Hajrullaut, lindur më 1932 në Peshkopi dhe banuese në Tiranë, në adresën e mësipërme, identifikuar me pasaportë Nr.0345392.

Te lartepërmendurit, madhorë, me aftësi të plotë juridike për të vepruar të cilët u morën vesh si më poshtë:

Neni 1

Palët pjesëmarrëse që nënshkruajnë këtë kontratë kanë dakort për krijimin e një Shoqërie, në bazë të këtij Akt - Themelimi si dhe Statuti, duke respektuar kërkesat e legjislationit shqiptar.

Neni 2

Emri i shoqërisë do të jetë "TOP ALBANIA" SH.A ("TOP ALBANIA" S.A.) dhe në vazhdim do të referohet si "shoqëria".

Neni 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është në fushën e RADIOS.

Objekt i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë veprimtaria radiofonike që përfshin prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji me anë të zërit, sinjaleve të koduara, shkrimit, të destinuara për publikun.



Për kryerjen e aktiviteteve që kërkojnë licencim, Shoqëria merr përsipër që me krijimin e saj si person juridik të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm pranë organeve kompetente për marrjen e licensave përkatëse.

- Për arritjen e këtij qëllimi Shoqëria ka të drejtë të bashkëpunojë me persona juridikë ose fizikë ose me cilëndo tjetër Shoqëri, brenda vendit ose jashtë vendit që ka të njëjtin qëllim.

Neni 4

Vendi i zhvillimit të veprimtarive të shoqërisë është territori i Shqipërisë, selia dhe zyrat qendrore të shoqërisë do të gjenden në Tiranë. Me vendim të Këshillit Mbikqyrës mund të hapen filiale, zyra dhe shërbime në të gjithë territorin e Shqipërisë si dhe jashtë Shqipërisë.

Neni 5

Kohëzgjatja e shoqërisë përcaktohet në 30 (tridhjetë) vjet, duke filluar që nga dita e regjistrimit të saj në Gjykatë. Shoqëria mund të priset dhe para se të mbarojë 30 vjeçari ose të shtyhet më tej se 30 vjeçari me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme të Aksionerëve, në bazë të Legjislacionit Shqiptar.

Neni 6

KAPITALI

Kapitali fillestar i shoqërisë përcaktohet në shumën 2.000.000 lekë (dy milion lekë). Kapitali ndahet në 2,000(dy mijë) aksione me vlerë nominale 1,000 (njëmijë) lekë secila.

Neni 7

Themeluesit të cilët nënshkruajnë këtë kontratë, kontribuojnë në kapital me këto shuma:

Emri	Numri i aksioneve	Vlera nominale (Lekë)
1. Vjollca HOXHA	800	800.000
2. Zhuljeta LAMAJ	800	800.000
3. Zyhra HAMITI	400	400.000


Neni 8


Statuti i cili i bashkangjitet këtij Akt - Themelimi, përbën pjesë plotësuese të këtij dokumenti dhe konsiderohet pjesë e pandashme e tij.


Neni 9

Ky Akt Themelimi është haruar në pesë kopje dhe pasi nënshkruhet me vullnetin e lirë të palëve përpara noterit, depozitohet një kopje në noterinë e Tiranës, një kopje në Gjykatën e Tiranës, një kopje pranë organeve tatimore dhe dy kopje depozitohen pranë shoqërisë.

ORTAKËT THEMELUES

1. Vjollca Hoxha


2. Shuljeta Demej


3. Zyhë Homiri


STATUTI I SHOQËRISË TREGTARE "TOP ALBANIA" SH.A.




Pjestarët e krijimit të shoqërisë tregtare "TOP ALBANIA"SH.A. të mbledhur sot më 05.05.2000, bazuar në ligjin Nr. 7638 datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", në Ligjin "Për rregjistrimin e shoqërive tregtare" Nr. 7667 datë 28.01.1993, si dhe në Ligjin Nr. 8410 datë 14.05.1997 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë" vendosën themelimin e shoqërisë "TOP ALBANIA"SH.A.

KAPITULLI I

Neni 1

KRIJIMI-FORMA-KOHËZGJATJA-EMËRTIMI-OBJEKTI-KAPITALI THEMELTAR

Aksionerët themelues të shoqërise janë:

- 1- Znj. Vjollca HOXHA. 
- 2- Znj. Zhuljeta LAMAJ. 
- 3-Znj. Zyhra HAMITI. 

Vendosën krijimin e shoqërisë anonime me emërtimin: **TOP ALBANIA Sh.A.**

Neni 2

Vendi i ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë, adresa e saj ligjore janë vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë. Me vendim të Këshillit Mbikqyrës mund të hapen zyra, filiale, shërbime dhe agjenci në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Selia e shoqërisë si dhe adresa e saj ligjore do të jetë në Tiranë pranë Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës.

Neni 3

Kohëzgjatja e shoqërisë përcaktohet në bazë të këtij statuti në 30 vjet, duke filluar nga data e rregjistrimit të saj në Gjykatë. Shoqëria mund të prishet edhe para se të mbarojë periudha 30 vjeçare ose të shtyhet kohëzgjatja e saj më tej se 30 vjetët, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, në bazë të legjislacionit shqiptar.

Neni 4

Objekt i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë në fushën e Radios dhe shprehimisht veprimtaria radiofonike që përfshin prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji me anë të zërit, sinjaleve të koduara, shkrimit, të destinuar për publikun.

- Për kryerjen e aktiviteteve që kërkojnë liçensim, Shoqëria merr përsipër që me krijimin e saj si person juridik të ndër marrë të gjithë hapat e nevojshëm pranë organeve kompetente për marrjen e liçensave përkatëse.

Për arritjen e këtij qëllimi Shoqëria ka të drejtë të bashkëpunojë me persona juridikë ose fizikë ose me cilëndo Shoqëri tjetër me të njëjtin objekt brenda vendit ose jashtë vendit që ka të njëjtin qëllim.

KAPITULLI II

Neni 5

KAPITALI THEMELTAR - AKSIONET

Kapitali themeltar i Shoqërisë përcaktohet në shumën 2,000,000 lekë (dy milion lekë). Kapitali ndahet në 2,000 (dy mijë) aksione me vlerë nominale 1,000 lekë (një mijë lekë) secili. Aksionet janë të pandashme.

NDRYSHIMI I KAPITALIT THEMELTAR

Neni 6

ZMADHIMI I KAPITALIT

Kapitali themeltar zmadhohet vetëm me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme dhe ndryshimit të Statutit, mbi bazën e raportit të Drejtorisë.

Kapitali Themeltar zmadhohet nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja ose nëpërmjet rritjes së vlerës nominale të aksioneve ekzistuese.

Aksionet e reja shlyhen me para në dorë ose me kontribut në natyrë.

Në rast se zmadhimi i kapitalit bëhet me kontribut në natyrë, me vendim të Gjykatës përkatëse, emërohen një ose më shumë ekspertë të cilët do të përcaktojnë vlerën e këtij kontributi në bazë të nenit 162 dhe kufizimet e neneve 168, 169 të L. 7638/92.

Aksionerët kanë të drejtë përparësie në nënshkrimin për rritjen e kapitalit. (E drejta e përparësisë).

Zmadhimi i kapitalit themeltar duhet të realizohet brenda 5 (pesë) vjetëve nga dita që Asambleja e Jashtëzakonshme ka miratuar këtë zmadhim (neni 153 L. 7638/92).

Neni 7

ZVOGËLIMI I KAPITALIT THEMELTAR

Zvogëlimi i kapitalit autorizohet ose vendoset nga Asambleja e Jashtëzakonshme. Në Asamblesë e Përgjithshme që thirret për zvogëlimin e kapitalit dorëzohet raporti i arsyetuar i Drejtorisë duke shpjeguar arsyet që bëjnë të detyrueshëm marrjen e vendimit përkatës. Në të gjitha rastet zvogëlimi prek aksionerët në të njëjtën masë në përpjestim me vlerën e aksioneve që zotërojnë, në bazë të nenit 164 të L. 7638/92.

Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontrollorë të autorizuar, të paktën 45 (dyzet e pesë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme që thirret për të vendosur mbi këtë projekt.

Neni 8

SHLYERJA DHE VERIFIKIMI I KAPITALIT

Nuk mund të merret vendim dhe të realizohet zmadhimi i kapitalit aksionar me para në dorë nëse kapitali aksionar i deri tanishëm nuk është shlyer plotësisht. Në rast të


Shënim: Ky dokument është i përdorur në procedurën e gjyqësorë.







kundërt operacioni i zmadhimit të kapitalit dhe lëshimit të aksioneve të reja konsiderohet i pavlefshëm, në bazë të nenit 153 L. 7638/92. Këshilli Mbikqyrës në çdo rast të zmadhimit të kapitalit duhet që në një afat tre (3) muaj nga realizimi i zmadhimit të kapitalit të verifikojë depozitimin e kapitalit. Nëse kapitali nuk është mbuluar plotësisht, atëherë Këshilli Mbikqyrës disponon lirshëm aksionet e pambuluara tek të tretët ose kapitali aksionar shtohet deri në shumën e mbulimit të tij.

KAPITULLI III

Neni 9

AKSIONET

Aksionet janë nominative. Për aksionet do të lëshohen tituj transferimi në bazë të ligjit, tipi i të cilave do të vendoset nga Këshilli Mbikqyrës i cili do të përcaktojë personat që do të firmosin titujt. Aksioni nominativ u transferohet të tretëve, në bazë të nenit 198 të L. 7638/92. Në kohën e themelimit të shoqërisë ose gjatë ekzistencës së saj mund të krijohen aksione me përparësi që kanë avantazhe në raport me të gjitha aksionet e tjera, sipas nenit 148 & 149 të L. 7638/92.

Neni 10

Aksionet janë të pandashme kundrejt Shoqërisë, e cila njih vetëm një pronar kryesor të një aksioni. Çdo aksion jep të drejtën e një vote. Në rastin kur për një aksion ka më shumë se një zotërues, atëherë të drejtat e tyre duhet t'i ushtrojnë nëpërmjet përfaqësuesit të tyre, por nëse nuk kanë caktuar përfaqësues, aksioni nuk përfaqësohet dhe ushtrimi i të drejtave që vijnë si pasojë e tij pezullohen.

Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga çdo aksion i ushtron vetëm prurësi i tij i ligjshëm.

Aksionerët ushtrojnë të drejtat e tyre përsa i përket drejtorisë së Shoqërisë nëpërmjet Asamblesë së Përgjithshme të aksionerëve.

Neni 11

Në rastin kur kushdo aksioner dëshiron të transferojë një pjesë ose të gjitha aksionet e tij, është i detyruar që më përpara të bëjë të njohur me shkrim tek Këshilli Mbikqyrës duke bërë të njohur edhe vlerën e aksioneve me qëllim që aksionerët e tjerë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për blerjen e këtyre aksioneve. Këshilli Mbikqyrës është i detyruar brenda dhjetë ditëve nga marrja e lajmërimit përkatës të lajmërojë me shkrim të gjithë aksionerët e tjerë. Aksionerët e tjerë kanë për detyrë që brenda afatit njëzet (20) ditor të bëjnë të njohur tek Këshilli Mbikqyrës nëse do të ushtrojnë të drejtën e parablerjes apo jo. Në rast se numri i aksionerëve që interesohen për blerje aksionesh është më i madh se një do të marrin aksione në përpjestim me numrin e aksioneve që zotërojnë. Çdo transferim aksionesh që bëhet në kundërshtim me këtë nen është i pavlefshëm dhe nuk sjell rezultat të ligjshëm si për aksionerët ashtu edhe për shoqërinë.

**KAPITULLI IV
ORGANET E SHOQËRISË**

**Neni 12
KËSHILLI MBIKQYRËS**

Përgjegjësia e drejtimit të Shoqërisë i takon Këshillit Mbikqyrës, i cili zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme dhe përbëhet nga 3 (tre) anëtarë (jo më pak se tre jo më shumë se 21, gjithmonë numër i përpjestueshëm me 3). Këshilli Mbikqyrës i parë që do të drejtojë shoqërinë është:

- 1-Znj.Zyhra HAMITI
- 2-Znj.Zhuljeta LAMAJ
- 3-Znj.Vjollca HOXHA

Këshilli Mbikqyrës emëron Drejtorin e Përgjithshëm të shoqërisë i cili e drejton dhe përfaqëson Shoqërinë.

Drejtori nuk mund të jetë anëtar i Këshillit Mbikqyrës. Drejtori është person fizik. Ai mund të zgjidhet edhe jashtë bashkësisë së aksionerëve.

Drejtori i parë i shoqërisë do të jetë:

- Z.Enkelejd JOTI.

Neni 13

Asambleja e Përgjithshme mund të zgjedhë si anëtarë të Këshillit Mbikqyrës edhe individë të cilët nuk janë aksionerë. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës nuk kanë përgjegjësi personale kundrejt të tretëve dhe kundrejt aksionerëve të shoqërisë. Por kanë përgjegjësi kundrejt personit Juridik të Shoqërisë për detyrat që u janë ngarkuar. Këshilli Mbikqyrës zgjedh kryetarin dhe nënkryetarin e tij. Kryetari kryeson mbledhjen dhe në mungesë të tij, zëvendësohet nga një nënkryetar.

Neni 14

Kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës caktohet për një periudhë 6 vjeçare e cila shtyhet deri në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që do të miratojë tabelat financiare (rezultatet) e vitit financiar që u mbyll dhe Asambleja e Përgjithshme do të mblidhet detyrimisht brenda gjashtë mujorit të parë nga mbyllja e vitit financiar.

Në rast vdekjeje, shkarkimi nga detyra ose të mungesës të pajustificuar të një anëtari të Këshillit Mbikqyrës nga mbledhjet për tre muaj rresht, Këshilli Mbikqyrës mund të zgjedhë zëvendës të tij deri në mbledhjen e parë të Asamblesë së Përgjithshme.

Këshilli Mbikqyrës thirret nga Kryetari dhe në rast se ai nuk ka mundësi ose mungon, thirret nga nënkryetari ose në raste të jashtëzakonshme mbas kërkesës të të paktën dy (2) anëtarëve, dhe vendimet merren me shumicë absolute votash të të pranishmëve dhe të votave të përfaqësuar. Këshilli Mbikqyrës ka quorum dhe mblidhet ligjërisht kur janë prezent ose përfaqësohen të paktën gjysma plus një e numrit të anëtarëve të tij. Anëtari i Këshillit Mbikqyrës që mungon mund të përfaqësohet në mbledhjen e Këshillit Mbikqyrës vetëm nga një anëtar i Këshillit Mbikqyrës.





Neni 15

Për diskutimet që bëhen dhe për vendimet që merren, mbahet procesverbal i cili nënshkruhet nga anëtarët prezent, në procesverbal shënohen edhe mendimet e atyre që nuk janë dakort.

Këshilli Mbikqyrës ushtron kontroll ndaj Drejtorisë për administrimin e shoqërisë nga ana e saj.

Ai ka të drejtë të kryejë në çdo kohë verifikimet dhe kontrollet që ai i çmon të arsyeshme dhe të kërkojë të njihet me dokumentat që ai i gjykon të nevojshme për plotësimin e detyrës së tij.

Këshilli Mbikqyrës nuk ka të drejtë të marrë vendim për çështje që janë në kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme.

Tek anëtarët e Këshillit Mbikqyrës jepet shpërblim i cili përcaktohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 16

Drejtoria përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët dhe është kompetente të vendosë për çdo çështje që ka të bëjë me drejtimin e saj, administrimin e pasurisë së saj dhe në përgjithësi në arritjen e qëllimeve të saj brenda objektit të shoqërisë, por kufizohet nga ato kompetenca që ligji ua jep shprehimisht Këshillit Mbikqyrës dhe Asamblesë së Aksionerëve.

Drejtoria i paraqet raport Këshillit Mbikqyrës të paktën një herë në tre muaj.

Neni 17

KONTROLLI I SHOQËRISË

Në shoqëritë anonime kontrolli ushtrohet nga eksperti kontabël i autorizuar.

Ekspertët kontabël të autorizuar emërohen nga Asambleja e Zakonshme në mbledhjen e saj, me përjashtim të ekspertit të parë të përcaktuar në Statut dhe kanë mandat një vjeçar. Eksperti i parë kontabël është:

- **Znj. Irena PULO**

Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një ekspert kontabël të autorizuar i cili ka këto veti:

Ndihmon në mbajtjen e llogarive të shoqërisë në mënyrë që ato të jenë sipas parimeve bazë të kontabilitetit.

Përgatit raportin vjetor të të dhënave ekonomike (bilanci, llogaria e fitimeve dhe humbjeve si dhe të dokumentave të tjera që kanë lidhje me to) dhe shpreh mendimin nëse të dhënat ekonomike reflektojnë realitetin e gjendjes ekonomike të shoqërisë.


Informon Këshillin Mbikqyrës në lidhje me ndonjë parregullsi të mundshme që vëhet re në shkëmbimet, procedurat, aktivet ose llogaritë e shoqërisë të cilat do të mund të çojnë në ekzistencën e humbjeve për shoqërinë.

Ekspertët kontabël të autorizuar sigurohen që është respektuar barazia ndërmjet aksionerëve.

Neni 18

Në rast të mos kryerjes me saktësi të detyrave të tij, eksperti kontabël i autorizuar mund të pezullohet nga detyra e tij me vendim Gjyqi i cili mblidhet dhe vendos me procedurë urgjente.


SHOQËRI E KRYEVE







Neni 19

Eksperti kontabël i autorizuar ka për detyrë të mbikqyrë llogaritë vjetore të cilat duhet të jenë të përpiluara në bazë të rregullave ndërkombëtare të pranuar dhe të shprehin me saktësi rezultatet e periudhës ushtrimore si dhe të japin me sinqeritet dhe rezultatin e dalë në fund të vitit Financiar. Eksperti kontabël ka dhe kompetencat që përcaktohen nga nenet 178, 179, 180 dhe 182 të L. 7638/92.

Eksperti kontabël ka mundësi, mbas kërkesës së tij, të ndihmohet në veprimtarinë e tij nga ekspertë të cilët do të emërohen nga Këshilli Mbikqyrës, në bazë të nenit 19 të L. 7560/92.

Neni 20

Ekspertët kontabël të autorizuar u bëjnë të njohur drejtorisë dhe këshillit mbikqyrës:

1. Kontrollat dhe verifikimet që kanë kryer dhe sondazhet e ndrushme që kanë bërë;
2. Pjesët e bilancit dhe të dokumentave të tjera të kontabilitetit në të cilat siaps tyre duhet të ishën bërë ndryshime, duke bërë gjithashtu edhe të gjitha vërejtjet e duhura mbi metodat e vlerësimit të përdorura në përpilimin e këtyre dokumentave;
3. Parregullshmëritë dhe pasaktësitë që kanë zbuluar;
4. Përfundimet që rrjedhin nga vërejtjet dhe korrigjimet e mësipërme mbi rezultatet e vitit financiar të mëparshëm.

Neni 21

Për ndërmarrjen e veprimeve dhe për derdhjen e shpërblimeve të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës, të drejtuesit dhe të Ekspertit Kontabël, zbatohen nenet 122-127 të L. 7638/92.

Neni 22

ASAMBLEJA E AKSIONERËVE

Asambleja e Aksionerëve është organi më i lartë i Shoqërisë dhe vendos për çdo çështje. Vendimet e Asamblesë së Aksionerëve janë angazhuese për aksionerët.

Vetëm Asambleja e Jashtëzakonshme ka të drejtën e ndryshimit të statutit, në lidhje me gjithë dispozitat e saj.

Çdo kusht tjetër konsiderohet i pavlefshëm.

Asambleja e Jashtëzakonshme mund të marrë vendime të vlefshme në rast se të pranishmit ose aksionerët e përfaqësuar përbëjnë të paktën 50 % të kapitalit aksionar, gjatë mbledhjes së saj të parë. Në rast se nuk ekziston shumica e duhur e mësipërme, Asambleja e Përgjithshme mund të anulohet për një ditë tjetër por, jo më shumë se dy (2) muaj nga dita e mbledhjes së parë, dhe mund të mbledhet pasi janë prezent personalisht ose përfaqësuesit e aksionerëve që përfaqësojnë 1/4 e kapitalit aksionar. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme merren me shumicën e ¾ të votave të të pranishmëve ose të votave të përfaqësuar.



Neni 23
ASAMBLEJA E ZAKONSHME

Asambleja e Zakonshme merr çdo vendim, përveç atyre që referohen në nenin 128 L. 7638/92.

Asambleja e Zakonshme merr vendim në mënyrë vendimtare për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shoqërinë. Për marrjen e vlefshme të vendimeve në Asamblenë e Zakonshme duhet të jenë prezent ose të përfaqesohet 1/4 e kapitalit aksioner. Në rast të mos arritjes së quorumit, Asambleja e Zakonshme thirret përsëri brenda muajit dhe këtë herë nuk kërkohet quorum. Vendimet e Asamblesë së Zakonshme merren me shumicë absolute të votave prezente ose të përfaqësuara.

Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme mbledhet një herë në vit ose brenda gjashtë mujorit mbas mbarimit të vitit financiar.

Ky afat mund të shtyhet me vendim gjyqi. Asambleja shqyrton dhe vendos për të gjitha çështjet e vitit financiar që u mbyll. Ajo ushtron kompetencat që ka në bazë të neneve 105, 108, 109, 123 dhe parag. 3 i nenit 125 të L. 7638/92.

Neni 24

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga Këshilli Mbikqyrës ose Drejtoria. Në mungesë të tyre do të thirret nga:

- 1) Nga ekspertët kontabël të autorizuar.
- 2) Nga personi i autorizuar nga gjykata mbas kërkesës të çdo të interesuari për një rast urgjent ose të një ose disa aksionerëve që të gjithë bashkë zotërojnë 1/10 e kapitalit.
- 3) Nga likuidatorët.

Mbledhja e Asamblesë të Aksionerëve realizohet ashtu siç përcaktohet nga ligji.

Neni 25

Mbledhja e Asambles së Përgjithshme për çështjet e rendit të ditës bëhet ashtu siç përcaktohet nga ligji. Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme edhe në rastin kur nuk janë zbatuar procedurat e thirrjes së përcaktuar nga ligji nëse në Asamblenë e Përgjithshme janë prezent ose përfaqësohen aksionerë që zotërojnë shumën e kapitalit aksionar dhe askush nuk mund të thotë diçka të kundërt. Rendi i ditës i Asamblesë së Aksionerëve përcaktohet nga personi që thërret Asamblenë e Përgjithshme. Rendi i ditës së Asamblesë nuk mund të ndryshohet me lajmërim të dytë.

Neni 26

Çdo aksioner/aksionere mund të përfaqësohet vetëm nga një aksioner tjetër ose nga e shoqja / i shoqi.

Neni 27

Drejtoria është e detyruar të vejë në dispozicion të aksionerëve para mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme dokumentacionin që përcaktohet nga neni 136 i ligjit 7638/92, sipas procedurës që përshkruhet në këtë nen.

Neni 28

Aksionerët që duan të marrin pjesë në Asamble duhet të dorëzojnë fillimisht në bankë ose aksionet e tyre ose çertifikatat e depozitimit të aksioneve nga një bankë tjetër.

Neni 29

Në rast se një aksioner i takon më shumë se një personi, për çdo shkak dhe arsye, ata janë të detyruar të përcaktojnë përfaqësuesin e tyre të përbashkët i cili do të ushtrojë të drejtat e tyre aksionere në përgjithësi.

Neni 30

Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës, anëtarët e drejtorisë dhe ekspertët kontabël të autorizuar mund të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme me vota konsultative. Ata kanë votë vendimore kur kanë cilësinë e aksionerit.

Neni 31

Emrat e atyre që marrin pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme shënohen në "Librin e Pjesëmarrjes".

Ecuria e mbledhjeve rregjistrohet në procesverbal.

Neni 32

Në Asambleshë e Përgjithshme kryeson Kryetari i Këshillit Mbikqyrës dhe kur mungon ai, kryeson nënkryetari ose përfaqësuesi nga anëtarët e pranishëm. Detyrat e sekretarit i zbaton ai që caktohet nga kryetari.

Neni 33

Duke filluar që nga momenti i Lajmërimit të Asamblesë së Përgjithshme të Zakonshme vjetore, çdo aksioner ose përfaqësuesi i tij që do ta përfaqësojë në asamble, ka të drejtë që në selinë e shoqërisë të informohet për të gjitha çështjet që parashikohen në nenin 143 L. 7638/92 dhe sidomos për këto:

Regjistrimi, bilanci vjetor, lista e anëtarëve të Drejtorisë si dhe listën e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës.

Raportet e Drejtorisë, të Këshillit Mbikqyrës dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar. Shumën e sakte të shpërblimit që marrin personat e mësipërm.





Neni 34

Çdo aksioner ka të drejtë të informohet ose të marrë kopje të listës së aksionerëve dhe të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë më parë se mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 35

Në rast të refuzimit të pjesshëm ose të plotë të së drejtës, së aksionerit nga ana e shoqërisë, për t'u informuar, e drejtë që i jepet nga nenet e mësipërme, aksioneri që konsideron se preket nga ky veprim, ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës.

Neni 36

TË DREJTAT E PAKICËS

Aksionerët të cilët përfaqësojnë një të dhjetën e kapitalit kanë mundësi të thërrasin Asamblenë e Jashtëzakonshme duke përcaktuar dhe çështjet e rendit të ditës. Këshilli Mbikqyrës është i detyruar të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme të kërkuar, përveç rastit kur ka një arsye shumë të rëndësishme. Aksionerët që përbëjnë një të dhjetën e kapitalit aksioner mund t'i drejtohen gjyqit që të kërkojnë kontrollin e ekzistencës së arsyes së rëndësishme dhe thirrjen e asamblesë me vendim gjyqi.

Me kërkesë të aksionerëve që përfaqësojnë një të dhjetën e kapitalit aksioner, Kryetari i Asamblesë ka mundësi të anulojë për një herë të vetme marrjen e vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Zakonshme ose të Jashtëzakonshme duke përcaktuar njëkohësisht dhe ditën e mbledhjes për marrjen e vendimit, ditë e cila nuk mund të jetë 30 ditë më pas nga dita e anulimit të mbledhjes së parë.

KAPITULLI VI

Neni 37

Shoqëria mban në zyrat e saj librat që kërkohen nga Ligji, ku do të mbahen llogaritë vjetore, tabelat financiare vjetore, bilancet ekonomike vjetore, raportet ekonomike vjetore, në të cilat duhet të përfshihet dhe çdo gjë tjetër që parashikohet nga ligji.

Librat zyrtare të shoqërisë dhe tabelat financiare vjetore, bilancet financiare dhe raportet financiare vjetore duhet të mbahen në gjuhën shqipe.

Neni 38

Viti financiar ka kohëzgjatje 12 (dymbëdhjetë) muaj, duke filluar nga data 1 Janar deri në datën 31 Dhjetor të çdo viti. Përrjashtohet viti i parë financiar që fillon nga data e rregjistrimit të shoqërisë në gjykatë dhe mbaron më 31.12.199...

Në fund të çdo viti financiar Këshilli Mbikqyrës bën Rregjistrimin (inventarin) dhe llogaritë vjetore në bazë të dispozitave të ligjit në fuqi për Kontabilitetin, si dhe përpilon raportin për Administrimin.



Neni 39
REZERVAT E DOMOSDOSHME

Krijohet kapitali rezervues i domosdoshëm i cili krijohet nga mbajtja e një përqindje të paktën 5 % nga fitimet neto të shoqërisë pasi më përpara janë zbritur humbjet e mundshme të viteve të mëparshme. Kjo procedurë pushon së qeni e detyrueshme kur shuma e kapitalit të rezervuar arrin masën e 1/10 të kapitalit të shoqërisë.

Neni 40
NDARJA E FITIMEVE

Fitimet që do të ndahen, përbëjnë fitimet e Vitit Financiar mbasi do të jenë zbritur rezervat dhe humbjet e mundshme të viteve të mëparshme, në bazë të nenit të mësipërm.

Neni 41
PËRCAKTIMI I DIVIDENTËVE

Mbas miratimit të bilancit vjetor dhe rregjistrimin e shumës që do të ndahet, Asambleja e Përgjithshme cakton shumën që do të ndahet tek aksionet me forcën e Dividentëve, në bazë të neneve 215, 216 të L. 7638/92 (në bazë të Kapitalit Aksioner).

KAPITULLI V

Neni 42
PRISHJA

Shoqëria prishet nëse ka mbaruar kohëzgjatja e saj ose në qoftë se ka shpallur falimentimin.

Neni 43
LIKUIDIMI

Likuidimi i shoqërisë bëhet në bazë të dispozitave që përcaktohen nga ligji. Shoqëria bën likuidimin e saj, që në momentin e prishjes së saj për çdo lloj arsye, me përjashtim të rastit të nenit 10 të L. 7638/92. Në emërtimin e shoqërisë në statutin e likuidimit, përfshihet edhe shprehja “në likuidim”. Ky tregues si dhe emri i likuidatorit duhet të shënohen në të gjitha veprimet dhe dokumentat që lëshon shoqëria tek të tretët.

KAPITULLI VI
Neni 44
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Për çështjet që nuk parashikohen nga statuti dhe gjatë themelimit të shoqërisë zbatohen dispozitat në fuqi të ligjit për Shoqëritë Anonime pa ofertë publike.



KAPITULLI VII
Neni 45
DISPOZITAT E FUNDIT
MBULIMI I KAPITALIT AKSIONER

Kapitali Aksioner mbulohet si më poshtë:

Emri	Nr. i aksioneve	Pjesmarrja (Lek)	Përqindja (%)
Vjollca HOXHA	800	80,000	40%
Zhuljeta LAMAJ	800	80,000	40%
Zyhra HAMITI	400	40,000	20%

Neni 46

Titulli i Shoqërisë caktohet “TOP ALBANIA” i cili përmbahet edhe në vulën e saj sipas neni 57 L. 7560/92.

Neni 47



Ky statut hartohet në katër kopje në gjuhën Shqipe dhe pasi u përpilua dhe u lexua, u nënshkrua nga Aksionerët e Shoqërisë.

Neni 48

DISPOZITA E FUNDIT

Kjo Shoqëri do të fillojë të funksionojë me kusht miratimin e veprimtarisë së saj nga autoritetet përkatëse shqiptare, në bazë të legjislacionit në fuqi dhe vetëm me këtë kusht.

AKSIONERËT THEMELUES

1. Vjollca Hoxha

2. Zhuljeta Lamaj

3. Zyhra Hamiti
